



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:276315

Datë: 29.08.2024

Numri i dokumentit: 06100973

P.nr.415/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Besart Prishtina, në çështjen penale kundër të pandehurit G. K. nga Mitrovica, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. A.L. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 315 paragrafi 1, pika 1.1, lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.1996/21, së datës 23.02.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik të datës 26.08.2024, në praninë e Prokurores së shtetit Ajtene Zoni, të pandehurit G. K. dhe mbrojtësit të tij Av. A. L. dhe të dëmtuarit D. K., pas shpalljes së aktgjykimit me datë 26.08.2024, me datë 29.08.2024, nxjerri, këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: G. K., nga i ati S., e ëma S., e gjinisë K., i lindur me datë ... me vendbanim në Mitrovicë, me numër personal ..., punon si automekanik, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i gjykuar.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Më datë ... rreth orës ... Komunën e Vushtrrisë, të pandehurit me dashje dhe me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete ose personin tjetër, kanë tentuar t'i marrin pasurinë e personit tjetër dhe atë të dëmtuarit D. K., ashtu që të pandehurit kishin shkuar në fshatin Pestovë dhe me ndihmën e mjeteve të forta kishin tentuar që t'i thyejnë derën e marketit "Dritoni", pronë e të dëmtuarit të lartcekur, të cilët fillimisht e kanë thyer drynin mbyllës të derës hyrëse të marketit e më pas dera kishte edhe dy mbyllje fizike nga brenda, ku të pandehurit nuk kanë mundur të depërtojnë brenda në market dhe janë tërhequr para se të realizojnë qëllimin e tyre për kryerjen e veprës penale,

- Me këtë në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 315, paragrafi 1, pika 1.1, lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 28, 31,38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 69, 70, 71, 72 dhe nenit 315 par.1, pika 1.1 të KPRK-së si dhe nenit 248, 365, 450 dhe 463 të KPPK-së, të pandehurin G. K., e

G J Y K O N

DËNIM ME GJOBË në shumë prej dymijë e pesëqind (2,500.00) Euro, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe DENIM ME KUSHT, duke i caktuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 viteve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 3 viteve.

Pala e dëmtuar D. K. për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej dyqind euro (200.00 €).

DETYROHET i pandehuri që në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej tridhjetë euro (30 €).

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.1996/21, 2021:0080647 e dt.23.02.2022, kundër të pandehurve K. U. nga Komuna e Mitrovicës, G. K. nga Mitrovica dhe B.Q. nga Mitrovica , për shkak të veprës penale Vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 28 dhe nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata me Aktvendimin e dt.04.11.2022 ka veçuar procedurën penale ndaj të pandehurit G. K. nga Mitrovica .

Gjyqtari i vetëm gjykues ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 03.11.2022, në të cilën seancë kanë qenë prezent Prokurori i shtetit, i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe i dëmtuari, ku pas leximit të aktakuzës, i pandehuri ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë dhe është njoftuar se ka të drejtë të paraqes kundërshtimet e tij lidhur me provat e cekura në aktakuzë dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës. I pandehuri nuk ka paraqitur kërkesë për hedhje të aktakuzës apo kundërshtim të provave.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datën 03.06.2024, i pandehuri është deklaruar i pafajshëm dhe palët i kanë paraqitur fjalët hyrëse, është bërë administrimi i provave materiale

dhe pasi që palët nuk kanë pasur ndonjë propozim për plotësimin e provave. I pandehuri G. K. ka zgjedhur që të mbrohet në heshtje dhe pas kësaj palët i kanë paraqitur fjalët përfundimtare.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor

Prokurori i shtetit në fjalën hyrëse të shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me administrimin e provave gjatë shqyrtimit gjyqësorë do të vërtetohej përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar, mbetem në tërësi pranë kësaj aktakuze meqenëse gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari G. K. ka kryer veprën penale e cila i vihet në barre sipas kësaj aktakuzë. Gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës vërtetohet nga dëshmia e dëshmitarit – të dëmtuarit D. K. e pastaj nga deklaratat e dëshmitarit O.Q. i cili në deklaratën e dhënë në stacionin policor ka pohuar faktin se vepra penale e kryer nga dy të akuzuarit K. U. dhe B.Q. ndërsa se i akuzuari G. K. në bashkëkryerje me dy të akuzuarit e tjerë ka kryer veprën penale, kjo u vërtetua nga video incizimi të cilën e patëm mundësinë të shohim gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku në baze të pamjes personi i cili shihet në video incizimi- konstrukti i tij është i njëjtë me të personit i cili gjendet sot në sallë, andaj duke u bazuar në këto që u thanë me lartë gjykatës i propozojmë që të pandehurin ta shpall fajtor për veprën penale të kryer, të i shqiptoj sanksion penale me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit ndërsa me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethane rënduese të merr parasysh shkallen e përgjegjësisë penale, intensitetin rrezikimit të vlerës së mbrojtur si dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale ndërsa sa i përket rrethanave lehtësuese në rastin konkret rrethana të tilla nuk kemi.

I dëmtuari në fjalën hyrëse dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit dhe njëherit ka kërkuar kompensim dëmi lidhur me këtë çështje penale.

Avokat mbrojtës i të pandehurit në fjalën hyrëse ka deklaruar se me asnjë provë të vetme nuk do të vërtetohet se i mbrojturi i tij e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, ndërsa në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ka theksuar se pas administrimit të provave nuk është vërtetuar se i mbajturi im ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet sipas aktakuzës së Prokurorisë. I njëjti ka shtuar se e vetmja indicie se i mbrojturi im ka kryer këtë vepër penale është deklarimi i bashkëpandehurit në polici se kinse me të ka qenë edhe i mbrojturi im G. K.. Tutje ka shtuar se deklaratat e bashkëpandehurit K. U. duhet të shpallet e papranueshme konform nenit 123 par. 1, pika 1.3, nenit 125, par. 1, pika 1.1 dhe nenit 251 par. 2 të KPP-së. Po ashtu deklarimet e dëshmitareve të dëmtuarit D. K. e po ashtu edhe të O.Q.t nuk vërtetohet fakti se i mbrojturi im ishte në vendin kontestues në momentin e kryerjes së veprës penale andaj duke u bazuar në të gjitha këto prova të shqyrtuara i propozojmë gjykatës që bazuar në nenin 363 par.1 pika 1.3 të KPPK, propozoj që gjykata të merr aktgjykim lirues meqenëse nuk është provuar që i mbrojturi im ka kryer veprën penale që akuzohet.

I pandehuri në fjalën hyrëse dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e avokatit mbrojtës.

Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor

Gjykata me rastin e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në pajtim me nenin 7 të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit në pajtim me ligjin, më vëmendje të plotë dhe me përkushtim profesional dhe me përkujdesje vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe faktet në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarit, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të tij, në vazhdim janë të shtjelluara provat e administruara, përfshirë:

Provat personale

Marrja në pyetje e dëshmitarit O.Q. në seancën e datës 03.06.2024, i cili ka deklaruar se me datën 17.11.2021 dhe me datën 20.02.2022 ka dhënë deklaratë në polici lidhur me këtë çështje penale duke shtuar se rasti i kujtohet pak. Tutje ka shtuar se vetura e tipi Peugeot është e vëllait tim B., dhe se i njëjti në ditën kritike e ke marr veturën dhe ka dal me të por që nuk e di ku ka shkuar ndërsa B., duke shtuar se nuk i kujtohet nëse të nesërmen vëllai i tij B. i ka treguar se ku ka mbetur vetura duke shtuar se raportet e tij me vëllain e tij janë të mira, ndërsa personat me të cilët shoqërohet vëllai tij, i njëjti nuk i njeh. I njëjti, tutje ka shtuar se nuk i kujtohet nëse policia i ka prezantuar video incizime dhe ka shtuar se i njëjti nuk e njeh personin K. U. me nofkën “Rusi” ndërsa G. K. e njoh si figurë dhe si kojshi por nuk kam raporte me të dhe se i njëjti nuk e ka parë vëllain e tij B. me G. K. asnjëherë.

Marrja në pyetje e të dëmtuarit, në cilësinë e dëshmitarit D. K., i cili ka deklaruar se në lidhje me rastin ka dhënë deklaratë në polici dhe Po ashtu ka dorëzuar video incizimet e nxjerra nga kamerat në raport me lokalit. I njëjti ka shtuar se nuk i kujtohet saktësisht ora dhe data s por se vendi ka qenë në fshatin Pestovë, në lokalit me emrin Dritoni Market, rreth orës 03:30 ose 04:00 e mëngjesit kur është ndezur alarmi, dhe me të shkuar te lokali kemi vërejtur se dera e lokalit ka qenë e dredhurar dhe dryni ka qenë i thyer, dhe përveç derës nuk ka pasur dëmtime të tjera ku për të njëjtën sot edhe kam dorëzuar faturën në gjykatë. Tutje ka shtuar është larguar një pjesë e kornizës së derës që ka qenë antracit ndërsa nuk është depërtuar brenda lokalit. I njëjti ka theksuar se me nxjerrjen e video incizimeve, të njëjtat i ka shikuar së bashku me policinë dhe se nuk ka mundur t’i identifikoj personat dhe fillimisht ka menduar se janë nga Vushtrria ndërsa më vonë e ka kuptuar se të njëjtit janë nga Mitrovica. Në fund i njëjti ka deklaruar se nuk e njeh të pandehurin.

Provat materiale

- Raporti policor ku përshkruhet se me datën 28.05.2021 në Stacionin Policor në Vushtrri është raportuar një rast i vjedhjes së rëndë në tentativë i cili ka ndodhur në Market “Dritoni” në fshatin Pestovë, në Vushtrri, ku sipas kamerave të sigurisë në lokalit në fjalë, rreth orës 02:22, shihen tre persona në tentim për të depërtuar brenda në market, me ç ‘rast kishin dëmtuar drynin që ishte në derën hyrëse por pasi që dera ishte siguruar edhe nga brenda me dy mbyllje fizike, të dyshuarit nuk kishin arritur të depërtonin brenda në market me ç ‘rast nuk kishin marrë asgjë.

- Procesverballi mbi marrjen në pyetje të të dëmtuarit D. K., i datës 28.05.2021 ku i njëjti ka deklaruar se rreth orës 06:00 kur ka shkuar për t'a hapë lokalin, marketin "Market Dritoni" ka vërejtur se dryni i jashtëm mungonte dhe të njëjtin e ka gjetur afër derës së lokalit, ndërsa në derë ka vërejtur shumë gërvishnje me siguri gjatë tentimit për t'a hapur derën. Tutje ka shtuar se pasi ka hyrë në lokal ka hapur kompjuterin, në të cilin i ka të instaluar kamerat ku ka vërejtur tre personi të cilët tentonin t'a hapnin derën e lokalit por që nuk i kanë dal. Sipas të dëmtuarit personat janë të moshës rreth 30 vjeçare por që janë të panjohur për të dëmtuarin.

- Procesverballit të marrjes në pyetje i dëshmitarit O.Q., i datës 17.11.2021, i cili kishte deklaruar se, kur i janë treguar video incizimet e vendit të ngjarjes të dy personave që shihen aty, i njëjti ka identifikuar personin me emrin K. U. me nofken Rusi dhe personin me emrin B.Q., i cili është vëllai i dëshmitarit. I njëjti ka deklaruar se është 100% i sigurt sepse K. e njeh se i njëjti është qel, ndërsa B. (vëllain e tij) në bazë të lëvizjes dhe mënyrës së ecjes. Poashtu ka deklaruar se K. nuk ka kerr dhe se me siguri ka ardhur me B..

- Video incizimet të cilat janë marrë nga i dëmtuari si prova dhe të prezantuara palëve pjesëmarrëse në shqyrtim gjyqësor; në fshatin Pestovë tek "Market Dritoni" rreth orës 02:21 shihen dy persona të cilët tentojnë t'a hapin me forcë lokalin "Market Dritoni" për disa minuta, por që të njëjtit nuk arrijnë të depërtojnë në brendësi të lokalit.

- Foto dokumentacioni 28.05.2021, ku në fotot 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 shihet pamja e vendit të ngjarjes, pra shihet lokali "Market Dritoni" dhe shihet dëmtimi që i është shkaktuar derës së lokalit dhe mbajtësve të drynit me rastin e tentimit të depërtimit në brendësi të lokalit.

Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet

Faktet jokontestuese

- Është fakt jo kontestues se me datë 25.05.2021 në fshatin në Vushtrri është tentuar të kryhet një vjedhje në lokalin "Dritoni Market" i cili është pronë e të dëmtuarit D.K.
- Është fakt jo – kontestues se vjedhja nuk ka mundur të përfundohet pasi që nuk është depërtuar brenda lokalit;
- Është fakt jo kontestues se gjatë tentimit të kryerjes së vjedhjes është dëmtuar dera e lokalit dhe është thyer dryni.
- Është fakt jo kontestues se dy të pandehurit K. U. dhe B.Q. ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale që është objekt i aktakuzës.

Këto fakte nuk janë kontestuar nga palët. Përveç kësaj këto fakte vërtetohen edhe nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor që janë pjesë e kësaj lënde penale.

Faktet kontestuese

- Është fakt kontestues se i pandehuri G. K. në ditën kritike ka qenë së bashku me dy të pandehurit tjerë K. U. edhe B.Q..

Ky fakt është kontestuar nga ana e të pandehurit përmes mbrojtësit të tij, në fjalën hyrëse si dhe në fjalën përfundimtare.

Vlerësimi i provave nga gjykata

Gjykata pas prezantimit të provave, plotësisht dhe përtej dyshimit të bazuar, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Këtë gjendje faktike, gjykata e vërtetoi në bazë të:

- Procesverbalit mbi marrjen në pyetje të të dëmtuarit D. K., të datës 28.05.2021, si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, është vërtetuar se rreth orës 06:00 kur ka shkuar për t'a hapë lokalit, marketin "Market Dritoni" ka vërejtur se dryni i jashtëm mungonte dhe të njëjtin e ka gjetur afër derës së lokalit, ndërsa në derë ka vërejtur shumë gërvishtje. Pasi ka hyrë në lokal ka hapur kompjuterin, në të cilin i ka të instaluara kamerat ka vërejtur tre personi të cilët tentonin t'a hapnin derën e lokalit por që nuk i kanë dal. Sipas të dëmtuarit personat janë të moshës rreth 30 vjeçare por që janë të panjohur për të dëmtuarin.

- Procesverbalit të marrjes në pyetje i dëshmitarit O.Q., i datës 17.11.2021, si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se kur i janë treguar video incizimet e vendit të ngjarjes të dy personave që shihen aty, i njëjti ka identifikuar personin me emrin K. U. me nofkën Rusi dhe personin me emrin B.Q., i cili është vëllai i dëshmitarit.

- Raportit policor të datës 28.05.2021, të përgatitur nga Stacioni Policor në Vushtrri është raportuar një rast i vjedhjes së rëndë në tentativë i cili ka ndodhur në Market "Dritoni" në fshatin, në Vushtrri, ku sipas kamerave të sigurisë në lokalit në fjalë, rreth orës 02:22, shihen tre persona në tentim për të depërtuar brenda në market, me ç 'rast kishin dëmtuar drynin që ishte në derën hyrëse por pasi që dera ishte siguruar edhe nga brenda me dy mbyllje fizike, të dyshuarit nuk kishin arritur të depërtonin brenda në market me ç 'rast nuk kishin marrë asgjë.

- Nga video incizimet e marra në lokalit "Market Dritoni" rreth orës 02:21 vërtetohet fakti se tre persona tentojnë t'a hapin me forcë lokalit "Market Dritoni" për disa minuta, por që të njëjtit nuk arrijnë të depërtojnë në brendësi të lokalit. Njëri nga personat është i pandehuri G. K., sipas vlerësimit të gjykatës në bazë të video incizimit ku shihet, fytyra e të pandehurit në profil, pamjes së trupit, si dhe mënyrës së ecjes së të pandehurit, i njëjti shihet duke udhëzuar të pandehurin tjetër gjatë tentimit për të kryere këtë vepër penale.

- Foto dokumentacioni i datës 28.05.2021, ku në fotot 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 me të cilat vërtetohet pamja e vendit të ngjarjes, si dhe dëmtimi që i është shkaktuar derës së lokalit dhe mbajtësve të drynit.

Për gjykatën deklarata e të dëmtuarit D. K., me rastin e marrjes në pyetje gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fazat e mëhershme ishte konsistente, e plotë dhe bindëse, e po ashtu ishte në harmoni edhe me incizimet e kamerave të sigurisë dhe me provat e tjera në shkresat e lëndës.

Se i pandehuri e ka kryer veprën penale së bashku me dy të pandehurit e tjerë vërtetohet në tërësi, përmes deklaramit të të dëmtuarit, nga video incizimet e kamerave të sigurisë së lokalit “Market Dritoni” si dhe nga foto dokumentacioni ku shihet pamja e lokalit që është tentuar të thyhet si dhe dëmtimet e shkaktuara. Se i pandehuri G. K. i ka kontribuar thelbësisht kryerjes së veprës penale është vërtetuar pasi që i njëjti në ditën kritike së bashku me të pandehurit K. U. dhe B.Q. kanë shkuar në fshatin, në Vushtrri, me ç ‘rast kanë tentuar të depërtojnë me forcë në lokalit “Market Dritoni” duke dëmtuar kështu drynin dhe derën e lokalit dhe pasi që nuk kanë mundur të depërtojnë në brendësi, me automjetin e markës Peugeot janë larguar nga vendi i ngjarjes.

Kjo gjykatë, konsideron se përtej çdo dyshimi të bazuar, është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, si në dispozitiv të aktgjykimit dhe se në veprimet e të pandehurit të, manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 315, paragrafi 1, pika 1.1, lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Gjykata lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykatat gjeti faktin se i njëjti ka filluar të punoj, është fejuar dhe pritët të krijojë familje, ndërsa si rrethanë rënduese rënduese për të pandehurin gjykata ka gjetur, shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, edhe më parë i gjykuar për vepra penale dhe atë përmes aktgjykimit P.nr.73/2022 si dhe aktgjykimit P.nr.571/2022.

Gjykatat në rastin konkret ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit ashtu siç parashihet me nenin 71 par 1 nën par 1.1 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së ku është përcaktuar se “Personi që tenton të kryej veprë penal dënohet si të kishte kryer veprën penale, por dënimi mund të zbutet”, e në rastin konkret gjykata ka zbutur dënim në aplikim të këtyre dispozitave.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i këtyre dënimeve ndaj të pandehurit është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë të të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t’i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu gjykatat ka vlerësuar edhe faktin se dispozitat e nenit 28 të KPRK-së parashohin

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar D. K. në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike lidhur me këtë çështje penale, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPK-së, ku është përcaktuar se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil”*, pasi që i dëmtuari nuk i ka ofruar gjykatës ndonjë dëshmi në lidhje me dëmin material dhe jo material të pësuar nga kjo vepër penale.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par 2 nën par 2.6 të KPPK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 358, 364, 449, 462 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.415/22, datë 29.08.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.